



Znj. Kesjana Halili (Dr.), aktualisht mban pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në INSTAT. Ajo ka një përvojë pune prej 14 vitesh në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht gjatë vitit 2020 ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Përgjithshme të Koordinimit të Borxhit Publik dhe Ndhmës së Huaj, për 6 vite ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, si dhe 7 vite ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.

Znj. Halili është angazhuar në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës që nga viti 2007. Si pjesë e angazhimit akademik ka botuar disa punime dhe ka marrë pjesë në një sërë konferencash dhe seminaresh.

Përvoja të tjera profesionale përfshijnë angazhimet si anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit nga viti 2014, anëtare e Autoritetit të Regjistrimit në Institutin e Audituesve ligjorë të Autorizuar nga viti 2018, anëtare e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të institucionit financiar NOA nga viti 2018.

Znj. Halili, respektivisht në vitet 2004 dhe 2006 ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master në Bankë dhe Financë, në Eastern Mediterranean University, Republika Turke e Qipros së Veriut. Në vitin 2016 ka fituar titullin Doktor i Shkencave, pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës në fushën e kërkimit sistemet e kontrollit të brendshëm në sektorin publik dhe ndikimi i auditimit të brendshëm në efektivitetin e tyre. Gjithashtu, Znj. Halili ka fituar titullin “Auditues i Brendshëm”, si dhe titullin profesional “Kontabilist i Miratuar”.